

20 gusht 2014, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA Muja filloi të hapet, por nuk mjafton

Pas thirrjeve të vazhdueshme të Forumit Transparenca drejtuar kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja që të hapë vendimmarrjen, para disa ditësh ai vendosi t'i hapë takimet e tij me drejtorët për mediat dhe shoqërinë civile. Për Forumin Transparenca, ky veprim paraqet një lëvizje pozitive drejt transparencës dhe llogaridhënies, por në asnjë mënyrë përmbushje të plotë të këtyre parimeve të qeverisjes demokratike. Për këtë arsye, ne i bëjmë thirrje kryetarit të komunës që këtë veprim fillestar ta pasojë me hapa të tjerë të rëndësishëm. Hapja e takimeve ku votohet vetëm formalisht dhe merren vendimet e dakorduara paraprakisht paraqet një manifestim të zbehtë të transparencës dhe llogaridhënies.

Për të vazhduar me veprime të njëmendta drejt qeverisjes demokratike, nga kryetari i komunës kërkojmë publikimin e gjithë materialit (propozimeve) një javë para se të mbahet takimi i tij me drejtorët. Kjo do të mundësonte hapjen e vendimmarrjes dhe do t'u ofronte kohë të mjaftueshme të gjitha palëve të interesuara që të japin komente para se të merren vendimet përfundimtare. Pasi që kryetari i komunës ka krijuar praktikën e takimeve përgatitore me drejtorët (një javë para takimeve të vendimmarrjes), nga ai kërkojmë që edhe ato takime t'i hapë për mediat dhe shoqërinë civile.

Në të njëjtën kohë, duke e vlerësuar rëndësinë që ka në qeverisjen demokratike, Forumi Transparenca kërkon që mediave dhe shoqërisë civile t'u ofrohet qasje në të gjitha fazat e procesit të prokurimit publik. Ne mendojmë që komuna e Prizrenit vazhdon të jetë e mbyllur, duke e kufizuar menaxhimin e parasë publike në disa individë brenda ekzekutivit. Kjo praktikë është në kundërshtim të plotë me parimet e qeverisjes transparente dhe llogaridhënese. Për këtë arsye, Forumi Transparenca kërkon që mediave dhe shoqërisë civile, e përmes tyre edhe gjithë qytetarëve, t'u ofrohet mundësia e monitorimit të të gjitha proceseve të prokurimit publik, nga vendimet për shpalljen e thirrjeve deri në hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

Forumi Transparenca është trup joformal i përbërë nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit, të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike dhe misioni i tij është koordinimi i veprimeve të këtyre akterëve për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale të Prizrenit.

Në emër të Forumit Transparenca,  
Elmedina Baxhaku, EC Ma Ndryshe (Sekretariati i Forumit Transparenca)  
Saraqët 5, 20000/Prizren  
[elmedina.baxhaku@ecmandryshe.org](mailto:elmedina.baxhaku@ecmandryshe.org)  
029 222 771